**BACHELOR NË KONTABILITET – FINANCË**

| | |
|---|---|
| **Emërtimi akademik i studimit** | **DIPLOMË UNIVERSITARE "BACHELOR" NË KONTABILITET – FINANCË** |
| Statusi i Akreditimit të programit të studimit | AKREDITUAR me Vendim nr. 06 , datë 10.01.2025 |
| Cikli i studimit | Cikli i parë (Bachelor) |
| Emri dhe statusi i insitucionit | Universiteti "Eqrem Çabej", Fakulteti Ekonomik, Institucion Publik, Akredituar |
| Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime | Shqip |
| Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit | 3 (tre) vite |
| Forma e studimit | Me kohë të plotë |
| Kriteret e pranimit | **a.** Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.<br><br>**b.** Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njëhësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.<br><br>**c.** Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore **(portali U-albania).**<br><br>*Përllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë* ***(për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).*** |

## OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit të studimit "Bachelor në Kontabilitet-Financë"është të aftësojë studentët me njohuri teorike dhe praktike në fushën e kontabilitetit, financës dhe menaxhimit financiar në sektorin publik dhe privat. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në analizën dhe interpretimin e pasqyrave financiare dhe raporteve kontabël,
2. Të zotërojnë njohuri të plota në fushat e kontabilitetit financiar, të kostos dhe të kontabilitetit publik,
3. Të aplikojnë parimet dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit,
4. Të aplikojnë teknika të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar në organizata të ndryshme private dhe publike,
5. Të përdorin software kontabël dhe pajisje moderne për regjistrimin dhe analizimin e të dhënave financiare,
6. Të njohin sistemet tatimore dhe legjislacionin financiar në funksion të përgatitjes dhe menaxhimit të dokumentacionit fiskal,
7. Të marrin vendime të arsyetuara financiare në kontekste të ndryshme organizative,
8. Të jenë të përgatitur për punësim në mënyrë të pavarur ose në grup në institucione publike, ndërmarrje private, institucione financiare apo organizata të tjera që kërkojnë ekspertizë në fushën e kontabilitetit dhe financës;
9. Të kenë baza të forta për të ndjekur studime të mëtejshme në nivelin Master.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e **Specialistit të Kontabilitetit dhe Financës, me Profil Kontabilist.**

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi profesionale, analitike dhe praktike që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin ekonomik dhe financiar, si në sektorin publik dhe atë privat, në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të kontabilitetit financiar dhe të kostos, analizës financiare, investimeve, menaxhimit dhe administrimit financiar, auditimit dhe kontrollit, sistemeve tatimore dhe financave publike, etj.

## VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm** (Hyrje në ekonomi, Historia e ekonomisë, E drejtë biznesi, Bazat e marketingut, Mikrekonomi, Bazë statistike.) **Kredite gjithsej: ~ 36 ECTS**
2. **Lëndë të formimit karakterizues** (Menaxhim biznesi, Bazat e financës, Makroekonomi, Parimet e kontabilitetit, Kontabiliteti financiar, Menaxhimi i burimeve njerëzore, Hyrje në modelim financiar, Financa publike, Etika dhe komunikimi në biznes, Drejtimi financiar, Investime, Kontabilitet kosto, Kontabilitet drejtimi, Kontabilitet publik, Menaxhim operacional, Njohuri mbi sistemin e tatim taksave.) **Kredite gjithsej: ~ 98 ECTS**
3. **Lëndë integruese** (Matematikë financiare, Statistikë e zbatuar, Lëndë me zgjedhje (2 grupe) **Kredite gjithsej: ~ 23 ECTS**
4. **Lëndë të formimit plotësues** (Gjuhë e huaj, Informatika, Kompjuterizim kontabël) **Kredite gjithsej: ~ 16 ECTS**
5. **Përgatitje punim diplome/ provim formimi. Kredite gjithsej: ~ 7 ECTS**

## SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 ( mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 ( mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

| NOTA | PIKËT |
|---|---|
| 4 (katër) | 0 në 44 pikë |
| 5 (pesë) | 45 - 54 pikë |
| 6 (gjashtë) | 55 - 64pikë |
| 7 (shtatë) | 65 - 74 pikë |
| 8 (tetë) | 75 – 84 pikë |
| 9 (nëntë) | 85 – 94 pikë |
| 10 (dhjetë) | 95 – 100 pikë |

## MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë Bachelor në "Kontabilitet-Financë" është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë në programin Bachelor në "Kontabilitet-Financë" është e dizenjuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë që paraqet tregu dinamik i punës në fushën e kontabilitetit, financës si dhe për vazhdimin e studimeve në ciklet më të avancuara.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit *Bachelor n*ë *Kontabilitet-Financë* mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë në *Financë, Kontabilitet, Auditim* apo në një fushë të ngjashme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë , në programet :

1. Master Profesional në Kontabilitet – Financë
2. Master i Shkencave në Financë - Kontabilitet

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t'u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

## MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë /ekspertë në fushën e kontabilitetit, financës dhe auditimit, të kualifikuar me njohuri të tilla si përgatitja dhe analizimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe menaxhimi financiar, njohja e legjislacionit tatimor dhe përdorimi i programeve bashkëkohore të kontabilitetit etj. Për këtë arsye synimi i programit të studimit Bachelor në "Kontabilitet-Financë" është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Institucione publike si njësi financiare, tatimore, kontabiliteti apo auditimi
2. Ndërmarrje private si specialistë të financës, kontabilistë apo financierë
3. Banka dhe institucione financiare
4. Shoqëri sigurimi dhe auditimi

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit "Bachelor" në"Kontabilitet-Financë" fitojnë njohuri në fushën e kontabilitetit financiar dhe të kostos, analizën dhe interpretimin e pasqyrave financiare, planifikimin dhe menaxhimin e burimeve financiare, sistemet tatimore dhe legjislacionin përkatës, auditimin dhe kontrollin financiar, përdorimin e software -ve bashkëkohorë të kontabilitetit dhe financës etj.

**DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (*plani mësimor* )**

| Nr. | Lënda | ECTS | Orë gjithësej | Semestri |
|---|---|---|---|---|
| **Viti i parë** | | | | |
| **1.** | Hyrje në ekonomi | **6** | **60** | **I** |
| **2.** | Historia e ekonomisë | **5** | **45** | **I** |
| **3.** | E drejtë biznesi | **6** | **60** | **II** |
| **4.** | Bazat e marketingut | **6** | **60** | **I** |
| **5.** | Menaxhim biznesi | **6** | **60** | **I** |
| **6.** | Matematikë financiare | **7** | **75** | **II** |
| **7.** | Bazat e financës | **6** | **60** | **II** |
| **8.** | Mikroekonomi | **6** | **60** | **I** |
| **9.** | Bazë statistike | **7** | **75** | **II** |
| **10.** | Gjuhë e huaj (Anglisht, Frëngjisht, Italisht) | **5** | **60** | **II** |
| **Gjithsej viti i parë** | | **60 ECTS** | **615** | |

| Nr. | Lënda | ECTS | Orë gjithësej | Semestri |
|---|---|---|---|---|
| **Viti i dytë** | | | | |
| **1.** | Makroekonomi | **7** | **75** | **I** |
| **2.** | Parimet e kontabilitetit | **6** | **60** | **I** |
| **3.** | Kontabiliteti financiar | **6** | **60** | **II** |
| **4.** | Menaxhim i Burimeve Njerëzore | **6** | **60** | **I** |
| **5.** | Statistikë e zbatuar | **6** | **60** | **I** |
| **6.** | Hyrje në modelim financiar | **6** | **60** | **II** |
| **7.** | Financa publike | **6** | **60** | **II** |
| **8.** | Etika dhe komunikimi në biznes | **6** | **60** | **II** |
| **9.** | Informatikë | **6** | **60** | **I** |
| **10.** | **Lëndë me zgjedhje** | **5** | **60** | **II** |
| | Menaxhim i biznesit të vogël | | | |
| | Shkrim dhe menaxhim projektesh | | | |
| | Ekonomi monetare | | | |
| | Shkrim akademik | | | |
| **Gjithsej viti i dytë** | | **60 ECTS** | **615** | |

| Nr. | Lënda | ECTS | Orë gjithësej | Semestri |
|---|---|---|---|---|
| **Viti i tretë** | | | | |
| **1.** | Drejtimi financiar | **7** | **75** | **I** |
| **2.** | Investime | **7** | **75** | **II** |
| **3.** | Kontabilitet kosto | **6** | **60** | **I** |
| **4.** | Kontabilitet drejtimi | **6** | **60** | **II** |
| **5.** | Kontabiliteti publik | **6** | **60** | **I** |
| **6.** | Menaxhim operacional | **5** | **60** | **I** |
| **7.** | Kompjuterizim kontabël | **5** | **60** | **II** |
| **8.** | Njohuri mbi sistemin e tatim taksave | **6** | **60** | **II** |
| **9.** | **Lëndë me zgjedhje** | **5** | **60** | **II** |
| | Kontabiliteti bankar | | | |
| | Kontabiliteti nacional | | | |
| | Kontabiliteti i shoqërive të sigurimit | | | |
| | Financa personale | | | |
| **10.** | **Provim formimi/Punim diplome** | **7** | **50** | |
| **Gjithsej viti i tretë** | | **60 ECTS** | **620** | |
| **Total : viti I + viti II + viti III** | | **180 ECTS** | **1850** | **-** |